



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01- Nr 020 - 3203 dt. 17.01 2020

Në vështrim të nenit 13 dhe 58 të Ligjit me nr. 03/L-040 për Vetqeversijën Lokale të Republikës së Kosovës, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenin 84, 85, 86 të Ligjit nr. 03/L – 212 të Punës në Republikën e Kosovës, nenit 17 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, nenit 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës, mori këtë:

V E N D I M

- I. Për emërimin e Komisionit disiplinor për shqyrtimin e inicimit të masave disiplinore për shkeljet e rënda të detyrave të punës, për të punësuarit në sektorin publik, të cilët nuk janë shërbyes civil, në këtë përbërje:
 1. Arbresa Dobra – Kryesues;
 2. Lumturije Kiqina – Anëtar;
 3. Lumnije Prenku – Anëtar.
- II. Komisioni i përbërë prej tre anëtarve do t'i shqyrtoj shkeljet e rënda të detyrave të punës në sektorin e Arsimit, Shëndëtsisë dhe Administratës Komunale në Komunën e Drenasit, dhe mandati i anëtarve të komisionit është dy vjeçar.
- III. Komisioni disiplinor për shkeljet e rënda të detyrave të punës nga nëpunësit që punojnë në sektorin publik, për inicimin e masave disiplinore do të njoftohen nga Drejtoritë përkatëse në kuadër të Komunës së Drenasit.

- IV. Shqiptimi i masave ndëshkuese për shkelje të rënda do të bazohet në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- V. Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.
- VI. Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet Vendimi Nr.01-020-2617, i datës 15.01.2020.
- VII. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.

Iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Personelit;
- Anëtareve të Komisionit;
- DKA-së;
- DSHMS-së;
- DAP-së;
- Arkivit të Komunës së Drenasit.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci